



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Anketa e Ekonomisë së Pavrojtuar në Kosovë 2017/2018





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Anketa e Ekonomisë së Pavrojtuar në Kosovë 2017/2018



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Mars, 2019

© : *Agjencia e Statistikave të Kosovës*

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet: <http://ask.rks-gov.net>

Parathënie

Anketa lidhur me Ekonominë e Pavrojtuar (EPV) në Kosovë

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Llogarive Kombëtare (DLLK), me mbështetjen e Bankës Botërore (BB), për herë të parë ka bërë matjen e ekonomisë së pavrojtuar në Kosovë, duke përfshirë katër (4) sektorë: transportin, hotelerinë, ndërtimtarinë dhe restorantet.

Mbulimi i plotë i prodhimit ekonomik është aspekt jetik i cilësisë së llogarive kombëtare. Kjo mbulueshmëri është e vështirë për t'u arritur për shkak të vështirësive në llogaritjen e llojeve të caktuara të aktiviteteve prodhuese. Aktivitetet që mungojnë në të dhënat bazë të përdorura për përpilimin e llogarive kombëtare, për shkak se ato janë të paligjshme, joformale, prodhim i ekonomive familjare për përdorim vetanak, ose për shkak të mangësive në sistemin bazë të mbledhjes së të dhënave, njihen si aktivitete të pavrojtura. Këto aktivitete përbëjnë ekonominë e pavrojtuar - EPV-në (Non-Observed Economy - NOE) dhe përfshirja e tyre në llogaritë kombëtare njihet si matje e EPV-së.

Termi përdoret nga Bashkimi Evropian (BE) në lidhje me programin e tij për të garantuar mbulueshmërinë e plotë të PBB-së. Një vendim i Komisionit Evropian (1994) thekson se "brenda kufijve të prodhimit, llogaritë kombëtare ofrojnë një matje shteruese të prodhimit kur ato mbulojnë prodhimin, të ardhurat primare dhe shpenzimet që janë drejtpërdrejt dhe jo drejtpërdrejt të vrojtura në të dhënat statistikore apo administrative."¹

Të dhënat e kësaj Ankete paraqesin gjendjen në këta sektorë për tremujorin TM3 2018 dhe vitin 2017. ASK duke u bazuar në këto të dhëna dhe burimet e të dhënave të tjera në dispozicion, do të nxjerrë edhe tregues tjerë në sektorët përkatës për shkallën e ekonomisë joformale. Treguesit final të nxjerrë nga kjo Anketë dhe nga Anketa tjetër që do të zhvillohet gjatë vitit 2019 lidhur me ekonominë joformale në ekonominë familjare dhe në sektorë tjerë formal, do të integrohen në të dhënat e Produktit të Brendshëm Bruto.

Agjencia e Statistikave të Kosovës i është mirënjohëse Bankës Botërore dhe të gjithë akterëve tjerë të cilë në mënyrë të drejtpërdrejt apo jo të drejtpërdrejt , kanë kontribuar në këtë publikim.

Mars, 2019

Kryeshef Ekzekutiv, ASK

Isa Krasniqi

¹ *Measuring the Non-Observed Economy, A Handbook - OECD (Bloem, A., Calzaroni, M., Charmes, J., Hussmanns, R., Ivanov, Y., Kazemier, B., et. al. (2002)*

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe mund të dërgohen në e-mail: economic@ks-gov.net.

Shkurtesat

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BB	-	Banka Botërore
BE	-	Bashkimi Evropian
DLLK	-	Departamenti i Llogarive Kombëtare
EPV	-	Ekonomia e Pa vrojtuar
RSB	-	Regjistri Statistikor i Bizneseve

Përmbajtja

faqe

Metodologjia	5
Anketa: Transporti rrugor	9
Anketa: Hotelet	12
Anketa: Restorantet.....	15
Anketa: Ndërtimtaria.....	18

Metodologjia

Mostra për katër sektorët (restorante, transport, hoteleri dhe ndërtimtari) është përgatitur nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në bazë të Regjistrimit Statistikor të Bizneseve (RSB), duke marrë parasysh kriteret relevante si madhësia e biznesit dhe aktiviteti ekonomik. Anketa është zhvilluar në të gjithë territorin e Kosovës.

Tabela 1. Mostra e zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Bizneseve

MOSTRA	
Sektorët	Numri i bizneseve
Restorante	2,074
Transport rrugor	578
Hotelieri	143
Ndërtimtari	1,486

Aktivitetet e ekonomisë së pavrojtuar grupohen në shtatë lloje, si në vijim:

Prapavijë statistikore: mos-përgjigje (Iloji 1 i EPV-së)

Ndikimi kryesor i mospërgjigjes është paragjykimi që përfshihet në produktin statistikor nëse të gjithë të anketuarit që nuk përgjigjen supozohet të kenë zero prodhim.

Prapavijë statistikore: njësitë që nuk janë azhurnuar (Iloji 2 i EPV-së)

Regjistri i biznesit mund të jetë i vjetëruar për arsyt e mëposhtme:

- janë përfshirë ndërmarrjet që nuk ekzistojnë më (të ashtuquajturat njësi të shuara);
- përjashtohen ndërmarrjet e reja;
- informacione të gabuara rreth ndërmarrjeve, për shkak të shkrirjes, ndarjes, etj;
- detaje të pasakta në lidhje me aktivitetin ekonomik, madhësinë e ndërmarrjes ose adresën.

Prapavijë statistikore: njësitë e pa regjistruara (Iloji 3 i EPV-së)

Ndërmarrjet mund të mungojnë plotësisht në burimet e të dhënave për shkak të arsyeve statistikore dhe jo sepse ato përpiqen të fshihen nga autoritetet.

Për shembull, kjo mund të ndodhë për shkak të shkallës së lartë të qarkullimit të ndërmarrjeve, i cili është një problem i zakonshëm në vendet ku numri i njësive prodhuese të vogla është veçanërisht i lartë ose për shkak të mungesës së ligjeve dhe rregullave adekuate statistikore, apo joefikasitetit në sistemin statistikor.

Prapavijë ekonomike: nën-raportimi (Iloji 4 i EPV-së)

Siç është theksuar më parë, vlera e shtuar mund të nënvlerësohet për të shmangur taksat, pagesat sociale, etj.

Prapavijë ekonomike: njësitë e pa regjistruara (Iloji 5 i EPV-së)

Disa ndërmarrje mund të mungojnë sepse pronarët e kanë shmangur qëllimisht obligimin për t'u regjistruar, në mënyrë që të shmangin kostot shtesë të llojeve të ndryshme, si taksat e vlerës së shtuar, kontributet e sigurimeve shoqërore, shpenzimet që lidhen me standardet e shëndetit dhe sigurisë, etj.

Mos-regjistrimi përfshin ndërmarrjet e pa regjistruara që mungojnë plotësisht, ose ndërmarrjet që janë regjistruar, por një ose më shumë njësi e tyre nuk janë të regjistruara.

Spektori joformal: njësitë e pa regjistruara (Iloji 6 i EPV-së)

Siç u tha më parë, mos-regjistrimi mund të jetë një kriter për përcaktimin e sektorit joformal dhe ndërmarrjet mund të mungojnë thjesht sepse nuk kërkohet të regjistrohen nga asnjë lloj legjislacioni.

Prodhimi ilegal: njësitë e pa regjistruara (Iloji 7 i EPV-së)

Në shumicën e rasteve njësitë prodhuese të paligjshme nuk janë të regjistruara. Në disa raste ato mund të regjistrohen por me përshkrime të pasakta të aktivitetit. Për shembull, shtëpitë publike ilegale mund të përshkruhen si klube shëndetësore ose sallone masazhesh, lojërat e fatit ilegale mund të përshkruhen si klube nate, etj. ²

² Measuring the Non-Observed Economy, A Handbook, OECD, 2002

Qasja tabelare e Eurostat-it - llojet e mosmbulueshmërisë së plotë/mos shterimit të plotë ³

Të pa regjistruar

N1 - Prodhuesi qëllimisht nuk është regjistruar – nëntokësore

Prodhuesi qëllimisht nuk regjistrohet për të shmangur detyrimet tatimore dhe të sigurimeve shoqërore. Më shpesh kjo i referohet prodhuesve të vegjël me qarkullim që tejkalojnë nivelet e pragut mbi të cilat duhet të regjistrohen. Prodhuesit që nuk regjistrohen sepse janë të angazhuar në aktivitete të paligjshme bien nën llojin N2. Lloji N1 nuk përfshin të gjitha aktivitetet nëntokësore, disa prej të cilave janë të lidhura me llojin N6.

N2 - Prodhuesit që qëllimisht nuk regjistrohen - të paligjshme

Prodhuesi qëllimisht nuk regjistrohet si njësi juridike ose si sipërmarrës sepse është i përfshirë në aktivitete të paligjshme. Lloji N2 përfshin aktivitete të paligjshme nga njësitë juridike të regjistruara ose sipërmarrësit që raportojnë (ose raportojnë gabimisht) aktivitetet e tyre sipas kodeve të veprimtarisë ligjore.

N3 - Prodhuesit që nuk kërkohen të regjistrohen

Prodhuesi nuk është i detyruar të regjistrohet sepse nuk ka prodhim për treg. Në mënyrë tipike, këta janë prodhuesit shtëpiak jo-tregtar që angazhohen në prodhimin e mallrave për konsum vetanak, për krijimin e kapitalit të vet, ndërtimin dhe riparimin e shtëpive. Ose, prodhuesi prodhon për treg, por është nën nivelin në të cilin prodhuesi është i detyruar të regjistrohet si sipërmarrës.

Të pa anketuar

N4 - Personat juridikë që nuk janë të anketuar

Personat juridikë që nuk janë të anketuar për shkak të disa arsyeve si: regjistri i bizneseve është i vjetëruar ose procedurat e azhurnimit janë të papërshtatshme; të dhënat e klasifikimit (aktiviteti, madhësia ose kodet gjeografike) janë të pasakta; personi juridik është përjashtuar nga korniza e mostres, sepse madhësia e tij është nën pragun e caktuar, etj. Kjo çon në përjashtimin (sistematik) të personit juridik nga anketat, kur në parim ai duhet të përfshihet.

N5 - Sipërmarrësit e regjistruar që nuk janë të anketuar

Sipërmarrësit e regjistruar nuk anketohen për shkak të arsyeve të mëposhtme: zyra e statistikave nuk kryen hulumtim të sipërmarrësve të regjistruar; sipërmarrësi i regjistruar nuk është në listën e sipërmarrësve të regjistruar në regjistrat e zyrës statistikore, ose nëse është në regjister, është përjashtuar sistematikisht prej tij; sipërmarrësi i regjistruar nuk është në kornizën e mostres, sepse të dhënat e klasifikimit (kodi i aktivitetit, kodi i madhësisë, kodi gjeografik) janë të pasakta.

³ *Non-Observed Economy in National Accounts – Survey of Country Practices, United Nations Publication, New York and Geneva 2008.*

Raportimi i pasaktë / keqraportimi

N6 - Prodhuesit qëllimisht keqraportojnë

Prodhimi bruto nën-raportohet dhe/ose konsumi i ndërmjetëm mbiraportohet, me qëllim shmangien e tatimit mbi të ardhurat, tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH), taksat e tjera ose kontributet e sigurimeve shoqërore. Raportimi i pasaktë shpesh përfshin mirëmbajtjen e dy grupeve të librave, pagesat e pagave në zarf të cilat regjistrohen si konsum i ndërmjetëm; pagesat në para të gatshme pa faturë dhe mashtrimet me TVSH.

Tjetër

N7 - Mangësi të tjera statistikore

Lloji N7 ndahet në N7a - të dhëna jo të plota, që nuk grumbullohen ose nuk grumbullohen direkt dhe N7b - të dhëna që trajtohen, përpunohen ose analizohen gabimisht nga statisticienët. Duhet të hetohen fushat në vijim: trajtimi i mospërgjigjes; prodhimi për përdorim vetanak nga prodhuesit për treg; bakshishet; pagat dhe mëditjet në formë të mallrave apo shërbimeve; dhe aktivitete sekondare.

Anketa: Transporti rrugor

Në këtë anketë janë intervistuar biznese që ushtrojnë aktivitetin e transportit rrugor dhe periudha referuese për mbledhjen e të dhënave është tremujori i tretë - TM3 2018. Në anketë janë përfshirë biznese që operojnë me llojet e automjeteve si në vijim: vetura, autobusë me më pak se 20 ulëse, autobusë me më shumë se 20 ulëse, kamionë me kapacitet prej 3.5 ton e më pak dhe kamionë me kapacitet mbi 3.5 ton.

Sipas klasifikimit të NACE Rev. 2, rreth 34% e bizneseve në këtë anketë merren me transport tjetër tokësor të udhëtarëve, rreth 31% e bizneseve veprojnë si taksi, duke vazhduar më pas me transport rrugor të mallrave (29%) dhe transport tokësor urban dhe periferik (6%).

Tabela 1: Struktura e bizneseve të anketuara sipas klasifikimit të NACE Rev.2

SEKSIONI H - TRANSPORTIMI DHE RUAJTJA	
Klasa	
4931 - Transport tokësor urban dhe periferik	6%
4932 - Taksi	31%
4939 - Transport tjetër tokësor i udhëtarëve	34%
4941 - Transport rrugor i mallrave	29%

Tabela 2 paraqet strukturën e automjeteve sipas llojit dhe vjetërsisë së tyre, ku rezultatet tregojnë se numri më i madh i automjeteve i takon kategorisë *10 e më shumë vjet të vjetër*, përjashtim bëjnë *veturat*, ku rreth 45% e tyre janë 0-5 vjet të vjetra.

Tabela 2: Automjetet sipas llojit dhe vjetërsisë së tyre në përqindje


Lloji i automjetit	Automjetet sipas vjetërsisë		
	0-5 vjet	5-9 vjet	10 e më shumë vjet
Vetura	45%	15%	40%
Autobusë me më pak se 20 ulëse	16%	23%	60%
Autobusë me më shumë se 20 ulëse	9%	21%	70%
Kamionë 3.5t dhe nën 3.5t	3%	23%	74%
Kamionë mbi 3.5t	3%	36%	61%

Tabela 3 paraqet numrin e bizneseve në përqindje sipas llojit të karburantit që përdorin për të kryer aktivitetin e tyre të përditshëm. Në përgjithësi, për shumicën e bizneseve, pavarësisht llojit të automjetit që përdorin për aktivitetin ekonomik, lloji i karburantit që përdorin më shumë për automjetet e tyre është nafta, më saktësisht rreth 94% e bizneseve që operojnë me vetura përdorin naftë, autobusë me më pak se 20 ulëse (91%), autobusë me më shumë se 20 ulëse (98%), kamionë 3.5 ton dhe nën 3.5 ton (83%) dhe kamionë mbi 3.5 ton (100%).


Tabela 3: Numri i bizneseve në përqindje sipas llojit të karburantit që përdorin

Lloji i automjetit	Lloji i karburantit		
	Naftë	Benzinë	Gaz
Vetura	94%	4%	1%
Autobusë me më pak se 20 ulëse	91%	6%	4%
Autobusë me më shumë se 20 ulëse	98%	2%	0%
Kamionë 3.5t dhe nën 3.5t	83%	17%	0%
Kamionë mbi 3.5t	100%	0%	0%

Grafiku më poshtë paraqet përdorimin mesatar të gjithë kapacitetit që bizneset kishin në dispozicion gjatë TM3 2018. Bizneset që operojnë me vetura, përdorën rreth 95 % të gjithë kapacitetit, ndërsa bizneset që operojnë me autobusë me më shumë se 20 ulëse nuk përdorën më shumë se 82 % të kapacitetit të tyre. Kapaciteti i përdorur për të gjitha llojet e automjeteve është i ngjashëm gjatë tre muajve. Ndër arsytet për mospërdorimin e gjithë kapacitetit në dispozicion, të cilat mund të ishin: mungesa e klientëve, mungesa e punëtorëve, probleme teknike apo arsye tjetër, bizneset më së shpeshti raportuan se kishin mungesë të klientëve.

Grafiku 1: Kapaciteti mesatar i përdorur gjatë TM3 2018 sipas llojit të automjetit

Grafiku i mëposhtëm tregon se gjatë muajit korrik, numri i punëtorëve me orar të plotë ishte mesatarisht 4.65, gjatë muajit gusht ishte 4.66 dhe shtator 4.73. Ndërsa, numri i punëtorëve familjarë pa pagesë është më i lartë në muajin gusht (mesatarisht 0.53 persona), krahasuar me korrik (mesatarisht 0.48) dhe shtator (mesatarisht 0.46 persona).

Grafiku 2: Punëtorët e rregullt me orar të plotë dhe punëtorët familjarë pa pagesë

Nga gjithsej 427 biznese sa ishin në mostër, në muajin korrik rreth 22% prej tyre deklaruan se kanë pasur të paktën një anëtar të familjes duke punuar për ta pa pagesë, në muajin gusht rreth 23% dhe në muajin shtator rreth 22%.

Anketa: Hotelet

Në këtë anketë janë intervistuar biznese që ushtrojnë aktivitetin e tyre si hotele në tërë territorin e Kosovës dhe periudha referuese për mbledhjen e të dhënave ishte tremujori i tretë - TM3 2018. Të dhënat janë mbledhur për kapacitetin e hoteleve për akomodim.

Tabela 1 paraqet gjithsej numrin e dhomave të hoteleve sipas kategorisë, ku rreth 47% të dhomave janë me nga një shtrat, 41% me dy shtretër, 7% me 3 e më shumë shtretër, 4% apartamente, 0,1% rezidencë dhe 1% tjetër.

Tabela 4: Kapaciteti i hoteleve për akomodim

Kategoritë	Gjithsej numri i dhomave
Me një shtrat	352
Me 2 shtretër	304
Me 3 e më shumë shtretër	56
Apartamente	30
Rezidencë	1
Tjetër	4
Gjithsej	747


Tabela 2 paraqet gjithsej numrin e dhomave sipas kategorisë dhe pajisjet në këto dhoma, duke përfshirë: banjot brenda dhomës, TV, internet, minibar, kondicioner dhe tharëse flokësh.

Tabela 5: Kapaciteti i hoteleve për akomodim dhe pajisjet në dhoma

Kategoritë	Numri i dhomave	Banjo brenda dhomës	TV	Internet	Minibar	Kondicioner	Tharëse flokësh	Të tjera
Me një shtrat	352	312	275	304	153	223	169	26
Me 2 shtretër	304	237	222	178	50	26	133	20
Me 3 e më shumë shtre	56	45	44	11	13	12	38	10
Apartamente	30	28	30	28	16	30	27	7
Rezidencë	1	0	1	1	0	0	0	0
Tjetër	4	0	4	2	0	3	0	0
Gjithsej	747	622	576	524	232	294	367	63


Numri mesatar i dhomave të raportuara nga hotelet e anketuara është 9 dhoma. Numri më i vogël i dhomave është një, ndërsa numri më i madh i dhomave të raportuara është 67.

Shumica e hoteleve të anketuara vepruan në mënyrë të përhershme gjatë tërë vitit të fundit (91%), ndërsa 9 % e tyre vepruan vetëm gjatë sezonës. Mesatarisht, hotelet që punuan vetëm gjatë sezonës në vitin e fundit, deklaruan se punuan përafërsisht tre muaj gjatë këtij viti.

Grafiku 3: Kohëzgjatja e aktivitetit gjatë tre muajve të fundit TM3 2018

Në përgjithësi, rezultatet e anketës tregojnë se sektori i hotelerisë ka gjasa të punësojë më shumë punëtorë gjatë muajit korrik dhe gusht, në krahasim me muajin shtator. Numri mesatar i punëtorëve familjarë pa pagesë në sektorin e hoteleve është relativisht i vogël dhe nuk i'u nënshtrua ndryshimeve të mëdha gjatë tre muajve të fundit.

Siç shihet në grafikun e mëposhtëm, numri mesatar i punëtorëve të përhershëm në hotelet e anketuara ishte pak më i lartë në muajin korrik (mesatarisht 5.97 persona) dhe gusht (mesatarisht 5.93), në krahasim me shtatorin (mesatarisht 5.73). Mirëpo, numri mesatar i punëtorëve që punuan gjatë këtyre tre muajve nuk ndryshoi shumë në sektorin e hoteleve. Shumë biznese në këtë sektor raportuan se kanë anëtarë të familjes duke punuar për ta dhe numri i tyre mbetet i ngjashëm gjatë tre muajve (mesatarisht 0.7 persona).

Grafiku 4: Numri mesatar i të punësuarve të përhershëm me orar të plotë

Numri i përgjithshëm i punëtorëve në sektorin e hoteleve përbëhet nga punëtorët me orar të plotë, punëtorët familjarë me apo pa pagesë, punëtorët sezonal me orar të plotë dhe punëtorët sezonal me orar të pjesshëm. Më shumë biznese raportuan se kanë punësuar punëtorë të përhershëm që punojnë me orar të plotë, sesa të tjerë që punojnë në kushte tjera. Në përgjithësi, shumica e hoteleve të anketuara nuk raportuan se kanë punësuar punëtorë me orar të pjesshëm.

Vetëm katër biznese raportuan se kanë punësuar punëtorë sezonal me orar të plotë gjatë tre muajve të fundit: korrik (mesatarisht 9 persona), gusht (mesatarisht 10 persona) dhe shtator (mesatarisht 8 persona).


Në pajtueshmëri me numrin më të madh të punëtorëve gjatë muajit korrik dhe gusht, pagat e raportuara gjatë këtyre dy muajve ishin më të mëdha sesa në muajin shtator. Për më shumë, pagat paraqesin kategorinë me më së shumti shpenzime gjatë tre muajve, ku mesatarisht për TM3 2018, hotelet kanë shpenzuar rreth 1,735 euro për paga. Të tjera produkte dhe shërbime për të cilat hotelet shpenzojnë më shumë janë uji, furnizimi me ushqime për mëngjes, detergjenti dhe taksat.

Anketa: Restorantet

Në këtë anketë janë intervistuar biznese që ushtrojnë aktivitetin e tyre si restorante në tërë territorin e Kosovës dhe periudha referuese për mbledhjen e të dhënave ishte tremujori i tretë - TM3 2018. Të dhënat janë mbledhur për kapacitetin e restoranteve dhe shërbimet që ofrojnë për konsumatorë.

Sa i përket aktivitetit të bizneseve të anketuara, siç prezantohet në Grafikon 1, aktiviteti më i shpeshtë ishte bar, kafeteri (44%), ushqimet e shpejta (34%), restorantet (31%) dhe klubet (1%). Një biznes ka mundur të ushtrojë një apo më shumë aktivitete. Rreth 8 % e bizneseve po ashtu raportuan se ofrojnë shërbime të tjera. Nga ky numër, shërbimet kryesore përfshijnë shërbimin e ushqimeve tradicionale, dyqane për ëmbëlsira, specialitete dhe qebaptore.


Grafiku 5: Struktura e restoranteve sipas llojit të aktivitetit



Siç përshkruhet në grafikun e mëposhtëm, shumica e bizneseve deklaruan se nuk kanë ndonjë njësi tjetër biznesore në ndonjë lokacion tjetër, përpos atij në të cilin veprojnë. Sidoqoftë, 7 % e bizneseve raportuan se ofrojnë shërbime biznesore në njësi apo lokacion tjetër po ashtu.

Më shumë se gjysma e bizneseve që ishin pjesë e kësaj ankete, raportuan se njësi biznesore në të cilën veprojnë me aktivitetin e tyre ekonomik është e marrë me qira, rreth 54 %. Rreth 35 % e bizneseve raportuan se njësi biznesore i takon atyre, pavarësisht nga lokacioni, përderisa 12 % e bizneseve veprojnë në një njësi që është pjesë e shtëpisë së tyre.


Grafiku 6: Statusi i njësive biznesore



Nga gjithsej 1,408 biznese që u anketuan, pjesa më e madhe e tyre raportuan se gjatë vitit të fundit aktiviteti i tyre biznesor ka qenë i përhershëm, rreth 97 %, ndërsa rreth 3 % e bizneseve tjera raportuan se kryejnë aktivitet sezonal, mesatarisht rreth 5 muaj gjatë vitit.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se restorantet punësuan më shumë punëtorë gjatë muajit korrik dhe gusht, në krahasim me muajin shtator. Ngjashëm, numri mesatar i punëtorëve familjarë pa pagesë po ashtu tregon rritje nga korriku (3.88) në gusht (4.29) dhe një rënie të vogël gjatë shtatorit (3.71). Grafiku i mëposhtëm paraqet rezultatet që tregojnë se bizneset patën mesatarisht 9.06 punëtorë gjatë korrikut, 9.66 në gusht dhe 8.70 në shtator.

Grafiku 7: Numri mesatar i të punësuarve të përhershëm sipas kategorisë



Një pjesë e konsiderueshme e bizneseve që ishin pjesë e kësaj ankete raportuan se kanë punësuar punëtorë familjarë pa pagesë gjatë tremujorit të fundit, qoftë të përhershëm (me orar të plotë dhe me orar të pjesshëm) apo sezonal (me orar të plotë dhe me orar të pjesshëm).

Tabela në vijim tregon numrin e bizneseve që raportuan se kanë të paktën një punëtorë familjar pa pagesë duke punuar për ta.


Tabela 6: Bizneset që punësuan punëtorë familjarë pa pagesë në përqindje

	Korrik	Gusht	Shtator
Numri i bizneseve	1,132	1,229	1,087
Numri i bizneseve nga mostra (1,408)	80%	87%	77%

Pjesa më e madhe e bizneseve që u anketuan, raportuan se kanë numër të madh të konsumatorëve çdo ditë (73 %), ndërsa 19 % e tyre raportuan se kanë numër të madh të konsumatorëve gjatë fundjavës apo periudhave të tjera (8%), si të premtën mbrëma apo ndonjë ditë specifike të javës.

Lidhur me konsumin dhe shpenzimet, të dhënat e mbledhura nga anketa tregojnë se gjatë një dite të zakonshme, kafja përbën 30 % të gjithë konsumit nga konsumatorët. Kjo pasohet nga ngrënia e darkës si vakt kryesor (26 %), uji dhe pijet jo-alkoolike (18 %) dhe birra (7 %).

Grafiku 8: Struktura e konsumit gjatë një dite të zakonshme



Ndësa sa i përket furnizimit të restoranteve me artikuj të nevojshëm, pjesa më e madhe e artikujve ofrohen direkt nga furnizuesi, duke përfshirë produkte si kafeja (76%), pijet alkoolike dhe jo-alkoolike (70% dhe 60% përkatësisht), vera (68%), rakia (60%), peshku, vezët dhe ëmbëlsirat (52% secila).


Anketa: Ndërtimtaria

Në këtë anketë janë intervistuar biznese që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e ndërtimit në tërë territorin e Kosovës dhe periudha referuese për mbledhjen e të dhënave ishte viti 2017.

Rezultatet tregojnë vlerën e ndërtimit, të ndarë në kategori të ndërtesave banesore, ndërtesave jo-banesore, infrastrukturës së transportit dhe ndërtesave të tjera, për të kuptuar më mirë aktivitetet biznesore dhe shpenzimet për kategori të ndryshme.

Një biznes i zakonshëm në sektorin e ndërtimit raportoi se rreth 89% e vlerës së punimeve të realizuara në vitin 2017 i takon kategorisë *Ndërtime të reja*, rreth 7% i takon kategorisë *Mirëmbajtje dhe riparime të vogla* dhe 4% *Riparime të mëdha të ndërtimeve ekzistuese*.


Grafiku 9: Vlera mesatare e punës ndërtimore të realizuar në 2017



Materialet për ndërtimari përbëjnë shpenzimet më të mëdha për kompanitë e të gjitha madhësive, ku kompanitë e mëdha shpenzuan 84 % të shpenzimeve të përgjithshme në vitin 2017 për blerjen e materialeve.

Mesatarisht, shpenzimet për materiale përbëjnë 61 % të të gjitha shpenzimeve të një kompanie të ndërtimit, pasuar nga pagat (20%), makineritë (10%), transporti (6%), energjia (1%) dhe shpenzime të tjera (2%).

Grafiku 10: Struktura e shpenzimeve sipas kategorive nga kompanitë e ndërtimit në vitin 2017



Agjencia e statistikave të Kosovës

përshkrim i shkurtër

Agjencia e statistikave të Kosovës është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha serive statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Programi i Statistikave Zyrtare, 2013/2017 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Agjencia e statistikave të Kosovës ka këtë strukturë organizative: Departamentet prodhuese; Departamenti i statistikave ekonomike, Departamenti i llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit dhe Departamenti i statistikave sociale. Departamentet mbështetëse; Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politika, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës. Në kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale; Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj

Të punësuar janë gjithsej 155 punëtorë, prej tyre, 100 (68,0%) në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 47 (32,0%), Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 75,5% me shkollim universitar, 12,3 me shkollim të lartë, ndërsa 12,3% me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

Agjencia e Statistikave të Kosovës mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njërive raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruet terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Rregjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

Misioni i Agjencionit; të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informatat të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- o **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë
- o **Telefoni:** +381 (0) 38 200 31 129
Kryeshefi Ekzekutiv: +381 (0) 38 200 31 112
- o **Fax::** +381 (0) 38 235 033
- o **E-mail:** infoask@rks-qov.net
- o **Ueb-faqe:** <http://ask.rks-qov.net>